

I nderuar z.T.....,

Në vijim të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se:

Në datë 19.02.2023, në vijim të veprimeve procedurialo-administrative të një operacionit policor është ushtruar kontroll nga strukturat ligjzbatuese (policia, doganat, kapiteneria) në një anije me flamur liberian. Nga veprimet e para hetimore dyshohet se ngarkesa që transporton ky mjet (naftë) është marrë nga vendet me embargo (Rusia).

Në vijim të veprimeve, u bë sekuestrimi i saj dhe i dokumentacionit shoqërues, si dhe bllokimi i ekuipazhit, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, po vijon hetimet, me qëllim dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie (të dyshuar e kundërligjshme) dhe për identifikimin e shtetasve të përfshirë në këtë veprimtari, si persona fizikë apo juridikë.

Bazuar në Kodin Doganor, autoriteti doganor kompetent vendos sekuestro të përkohshme për mallrat që janë objekt i kontrabandës, përfshirë edhe mallrat që nuk taten.

(“autoritete doganore kompetente” do të thotë autoritetet doganore që ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontrolle në zonën ku është kryer dhe verifikuar shkelja apo në zonën ku ajo është kompetente në një territor të caktuar).

Personi/nat ndaj të cilit/eve zbatohet sanksioni administrativ për kontrabandën, procedohet penalisht në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Procedimet administrative, si dhe çdo veprim tjetër pezullohen nga ana e autoritetit doganor kompetent, kur ka filluar një procedim penal kundër të njëjtit person në lidhje me të njëjtat fakte.

Objektet e kontrabandës konfiskohen me vendim të gjykatës, në përputhje me përcaktimet e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Për sa përmendëm më sipër, rasti është në shqyrtim të organeve kompetente të procedimit penal, (Kodi Penal prevalon mbi Kodin Doganor), dhe si i tillë informacionin që ju kërkon nuk disponohet nga DPD. Ju duhet ti drejtoheni institucionit përkatës procedues.

Lidhur me pyetjen se *Cfare masash ndeshkimore parashikon legjislacioni shqiptar per thyerjen e embargos nderkombetare?*

Bazuar në ligjin nr. 102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), në rastet kur identifikohen ngarkesa që ndalohen të importohen në RSH, në bazë të masave shtrënguese ndërkombëtare, procedura doganore ndërpritet (malli nuk hyn në territorin doganor) dhe malli kthehet mbrapsht dhe/ose sekuestrohet. Sipas kuadrit ligjor ekzistues, autoritetet doganore kompetente (pikat doganore) duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat, duke përfshirë, sipas rastit: a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e kundërvajtjes; b) faktin nëse personi përgjegjës për shkeljen është operator ekonomik i autorizuar; c) shumën e shmangur të detyrimit të importit ose eksportit; ç) faktin nëse mallrat e përfshira janë objekt i ndalimeve ose kufizimeve të përcaktuara në paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 125, dhe në shkronjën “d”, të pikës 3, të nenit 239, ose paraqesin rrezik ndaj sigurisë publike; d) nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës për shkeljen me autoritetin kompetent; dh) shkeljet e mëparshme nga ana e personit përgjegjës për shkeljen, etj.

Per sa i perket pyetjes së fundit, në bazë të të dhënave që disponon DPD (Dr. Antitrafik), në 12 muajt e fundit janë konstatuar 7 raste të tentativave për të importuar mallra që ndalohen nëse janë me vend eksportues apo vend origjine Libinë dhe Rusinë. Përkatësisht 3 raste nga Libia dhe 4 raste nga Federata Ruse.

(të dhënat janë bazuar vetem në kontrollet (fizike dhe online) qe kjo drejtori ka zhvilluar në bashkëpunim me strukturat e DPD-së dhe jo për rastet e ndalimeve që mund të jenë konstatuar nga Degët Doganore.)

Duke ju falenderuar per mirkuptimin.